

# E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Fokusi i muajit

### Kërkesa për informacion

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përkufizon termin "Informacion publik" si çdo dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme e formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo përfshin çdo lloj informacioni të regjistruar në:

- letër
- skedarë kompjuteri
- email
- video

Kërkesa për informacion bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose email. Informacioni mund të dërgohet në adresat zyrtare të autoritetit. Ligji nuk ndalon që informacioni ti kërkohej çdo funksionari publik, megjithatë Zyra e Komisionerit sugjeron dërgimin e kërkesës në adresë të koordinatorit për të drejtën e informimit.

Kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit gjenden në faqen zyrtare të autoritetit publik por mund të gjenden edhe në portalin "pyetshtetin.al". Kërkesa duhet të përmbajë nënshkrimin e kërkuarit dhe një adresë të saktë në mënyrë që autoriteti të dërgojë përgjigjen. Nëse informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale duhet të vendoset në dispozicion të autoritetit publik një kopje e dokumentit të identifikimit.

Kërkesa për informacion duhet të jetë e qartë në lidhje me informacionin që kërkohej. Nëse kërkuari nuk është i sigurt se çfarë informacioni konkret dëshiron, atëherë autoriteti publik duhet të ofrojë asistencë për të përshkruar qartë informacionin e kërkuar dhe se kujt autoriteti publik duhet drejtuar kërkesa.

## Përmbledhje mujore e vendimeve

### Vendim Nr. 49 -

Vendimet e A.P. mbi inspektimet financiare janë vendime që publikohen në mënyrë proaktive

### Vendim Nr. 50 -

Çdo person ka të drejtë të njihet me informacion publik

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit nëntor, ka dhënë 2 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) të cilat kanë qenë vendime urdhërimi ndaj autoriteteve publike për të dhënë informacionin e kërkuar.

Me anë të Vendimit nr. 50 datë 25.11.2020 Zyra e Komisionerit ka pranuar ankesën e Qendrës Res Publica i cili i kërkonte Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) informacion mbi detyrimet e papaguara nga ana e kompanisë A. R. M. O, vlerën e detyrimeve të papaguara, masat/vendime që janë marrë nga DPT për detyrimet e papaguara nga kompania A. R. M. O., pasi DPT ka vënë në dispozicion të kërkuarit informacion vetëm për pikën e parë të kërkesës duke refuzuar pjesën tjetër të saj.

Në ndjekje të procedurave administrative me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, KDIMDP ftoi palët në një seancë dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KDIMDP, në prani të dy palëve përfaqësuesit e DPT arsyetonin se të dhënat e kërkuara nga ankuesi janë konfidenciale bazuar në nenin 24, nenin 25 dhe 31 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar si edhe neni 17 i LDI.

KDIMDP vlerëson se, refuzimi i dhënies së informacionit mbi bazën e nenit 24 të ligjit "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nuk qendron pasi dispozita në fjalë parashikon autoritetet të cilëve iu ofrohet pa pagesë informacioni tatimor në lidhje me një tatimpagues të caktuar, por nuk parashikon ndalimin e dhënies së informacionit tatimor për subjekte të tjera.



Imazh ilustrues

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

## #informim #transparencë #vendim

Qëllimi i nenit 24 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nuk është përjashtimi i subjekteve të përmendura në të, nga aksesimi në informacionin e administruar nga administrata tatimore, por thjeshtimi i marrëdhënieve dhe komunikimit midis administratës tatimore me këto institucione, efica dencia dhe deburokratizimi i administratës publike, si dhe ekonomia gjyqësore. Gjithashtu dispozitat e nenit 24 janë të zbatueshme dhe për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të LDI dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i një procesi gjyqësor civil apo penal.

Lidhur me kufizimin e parashikuar në nenin 25 të ligjit të sipërcituar, në të cilën parashikohet: *Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore dhe vendore ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës. Kjo pikë nuk zbatohet për detyrimet tatimore, për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë.* KDIMDP vlerëson se, dispozita është vetëshpjeguese përderisa ndaj subjektit të kërkuar ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve të pashlyera.

Gjithashtu, KDIMDP vlerëson se refuzimi i dhënies së informacionit bazuar në nenin 17 të LDI është i pambështetur në ligj. Kjo, pasi neni 17 i këtij ligji liston qartë rastet kur dhënia e informacionit mund kufizohet dhe në vlerësimin e KDIMDP, rasti konkret nuk mund të kategorizohet si subjekt i asnjë prej kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të LDI.


Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës KDIMDP vendosi Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar. Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).



# **INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË 61 NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE**

**RAPORT MONITORIMI**

DHJETOR 2020



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

# Transparenca proaktive e njësive të vetëqeverisjes vendore

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar Programet e Transparencës të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2020. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar prej janarit 2019. Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 4 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Publikimi i Programit të Transparencës;
- Përditësimi i “Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve” gjatë vitit 2020;
- Publikimin e të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Instalimi i “Regjistrit elektronik për kërkesat dhe përgjigjet për të drejtën e informimit” (REKPMI);

Çdo tregues merr një vlerë 0 ose 1 pikë. Ky sistem matjeje i transparencës proaktive ngjan me një sistem semafori.




**Semafor i Kuq - Transparencë Proaktive Negative = 0 pikë**

**Semafor i Verdhë - Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme = 1 pikë**

**Semafor i Bardhë - Transparencë Proaktive Minimale = 2 ose 3 pikë**

**Semafor i Gjelbër - Transparencë Proaktive Funksionale = 4 pikë**

# Transparenca proaktive e njësive të vetëqeverisjes vendore



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar Programet e Transparencës të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2020. Në një seancë dëgjimore të realizuar nëpërmjet platformave online për shkak të situatës me pandeminë COVID-19, u prezantuan nga ana e Zyrës së Komisionerit gjetjet e këtij monitorimi me pjesëmarrjen e kryetarëve apo përfaqësuesve të tyre, si dhe koordinatorëve nga 61 bashkitë e vendit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore draft raportin për të marrë komentet e tyre në lidhje me gjetjet përfundimtare të monitorimit duke i lënë një afat kohor të shkurtër për reagimin e tyre.

Pas marrjes së komenteve nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, në muajin dhjetor 2020 Zyra e Komisionerit publikoi raportin përfundimtar "Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" i cilin gjendet i publikuar në faqen zyrtare [www.idp.al](http://www.idp.al)

